

Statistikat vjetore të krimeve, 2019

Tiranë, më 30 Prill 2020: Në këtë publikim, statistikat e krimeve japin informacion mbi veprat penale, autorë të veprave penale, persona të dëmtuar, procedimet penale, persona të pandehur dhe të dhëna mbi të burgosurit.


Vepra penale

Në vitin 2019, janë evidentuar gjithsej 35.210 vepra penale, 2,2 % më shumë, krahasuar me vitin 2018. Në 2019, në raport me popullsinë, janë evidentuar 123,4 vepra penale për 10 mijë banorë, nga 120,2 vepra që ishin në vitin 2018.

Tab. 1 Vepra penale të evidentuara

Veprat penale	2015	2016	2017	2018	2019
Vrasje me dashje	54	71	50	51	58
Vrasje të mbetura në tentativa	138	132	129	114	76
Krime me dashje kundër shëndetit	2.892	2.579	2.650	2.493	2.449
Krime seksuale	149	120	113	110	155
Vjedhje (neni 134)	5.091	4.363	4.351	4.532	4.290
Vjedhje me dhunë	182	138	169	108	85
Vjedhje me armë	49	15	13	22	13
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	150	81	118	70	76
Mashtrime	803	1.031	1.127	1.040	959
Fallsifikim monedhash	125	73	85	82	84
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.300	1.488	1.412	1.374	1.341
Krime në fushën e drogës	2.321	3.248	2.070	1.907	1.989
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	5.280	5.357	5.316	5.713	5.652
Tjetër	19.852	17.129	18.864	19.065	17.983
Gjithsej	35.864	33.808	34.317	34.468	35.210
Për 10 mijë banorë	124,5	117,5	119,4	120,2	123,4

Fig. 1 Ndryshimi në përqindje i veprave penale, 2018-2019



Autorë të veprave penale


Në vitin 2019, janë regjistruar 43.045 autorë për vepër penale, 8,6 % më shumë, krahasuar me vitin 2018. Numri i autorëve sipas veprave penale përfshin numrin e personave të dyshuar të cilët mund të jenë të pranishëm në më shumë se një vepër penale dhe autori numërohet në të gjitha veprat ku është i dyshuar. Ndërkohë, numri i autorëve pa përsëritje në veprat penale, në vitin 2019 është 36.083 autorë, 4,5 % më pak, krahasuar me vitin 2018.

Tab. 2 Autorë për vepër penale

Vepra penale	2015	2016	2017	2018	2019
Vrasje me dashje	81	80	48	60	78
Vrasje të mbetura në tentativë	190	164	156	149	96
Krime me dashje kundër shëndetit	3.665	3.282	3.487	3.264	3.279
Krime seksuale	163	127	111	114	162
Vjedhje(neni 134)	807	824	629	3.178	2.608
Vjedhje me dhunë	131	123	157	115	101
Vjedhje me armë	474	354	381	23	34
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	164	88	130	77	104
Mashtrime	855	1.086	1.141	1.033	983
Fallsifikim monedhash	102	70	81	77	69
Dhuna në familje (neni 130/a)	1359	1.586	1.507	1.459	1.438
Krime në fushën e drogës	2.189	2.489	2.482	2.357	2.703
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	5.108	5.096	5.173	5.530	5.473
Tjetër	21.824	19.305	20.568	22.213	25.917
Autorë Gjithsej	37.112	34.674	36.051	39.649	43.045
Autorë pa përsëritje të veprave penale	34.093	31.231	32.289	34.537	36.083


Në vitin 2019, meshkujt përbëjnë 93,9 % të autorëve për vepër penale.

Fig. 2 Autorë gjithsej dhe autorë meshkuj për vepër penale



Në vitin 2019, 33,1 % e autorëve janë të grupmoshës 30-44 vjeç, 28,0 % të grupmoshës 18-29 vjeç dhe 25,7 % i përkasin grupmoshës 45-59 vjeç, edhe në raport me popullsinë, renditja e autorëve sipas grupmoshave është e njëjtë.

Fig. 3 Autorë për vepra penale sipas grupmoshave, 2019



Të dëmtuar


Në vitin 2019, janë regjistruar 18.858 persona të dëmtuar, 1,3 % më pak, krahasuar me vitin 2018. Në vitin 2019, të dëmtuarit për krime kundër personit përbëjnë 35,7 % të totalit të personave të dëmtuar.

Tab. 3 Të dëmtuar për krime kundër personit

Të dëmtuar	2015	2016	2017	2018	2019
Krime kundër jetës	1.768	1.673	1.606	1.652	1.401
Krime kundër shëndetit	3.359	3.011	3.239	2.982	2.986
Krime seksuale	146	121	114	105	148
Vepra penale kundër lirisë së personit	234	165	146	173	181
Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit	366	403	350	335	321
Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes	1.544	1.804	1.777	1.736	1.652
Të tjera kundër personit	25	19	25	24	40
Të dëmtuar për krime kundër personit	7.442	7.196	7.257	7.007	6.729
Të dëmtuar gjithsej	20.168	19.078	19.062	19.101	18.858

Në vitin 2019, në totalin e personave të dëmtuar për krime kundër personit, femrat përbëjnë 34,1 % të të dëmtuarve dhe përqindja më e madhe e tyre vihet re në krime seksuale, krime kundër moralit, dinjitetit si edhe krime kundër fëmijëve, martesës dhe familjes.

Fig. 4 Të dëmtuar për krime kundër personit sipas gjinisë, 2019




Procedime penale

Në vitin 2019, numri i procedimeve penale të regjistruara është 30.695 procedime, 2,2 % më pak, krahasuar me vitin 2018. Në vitin 2019, nga 26.307 procedime penale të përfunduara, 22,1 % e tyre janë pushuar, 38,3 % janë pezulluar dhe 39,5 % janë dërguar për gjykim në gjykatë.

Tab. 4 Procedime penale të regjistruara

Veprat penale	2015	2016	2017	2018	2019
Vrasje me dashje	141	167	120	126	137
Vrasje të mbetura në tentativë	49	51	43	52	28
Krime me dashje kundër shëndetit	822	738	862	908	903
Krime seksuale	130	109	102	113	158
Vjedhje (neni 134)	10.065	9.920	9.514	9.219	8.682
Vjedhja me dhunë	258	146	187	118	117
Vjedhja me armë	58	31	22	35	15
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	147	97	127	114	85
Mashtrime	1.071	1.401	1.060	872	745
Fallsifikim monedhash	133	94	78	80	82
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.206	1.355	1.310	1.209	1140
Krime në fushën e drogës	2.033	2.795	1.764	1.524	1.548
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	3.659	3.681	3.639	4.121	4.038
Tjetër	12.680	10.698	12.634	12.898	13.017
Gjithsej	32.452	31.283	31.462	31.389	30.695

Fig. 5 Progresi i procedimeve penale të përfunduara



Të pandehur


Në vitin 2019, janë regjistruar 14.721 persona të pandehur, 9,4 % më pak, krahasuar me vitin 2018. Në vitin 2019, të pandehurit e rritur përbëjnë 97,0 %, të miturit zënë 3,0 % në totalin e personave të pandehur.

Tab. 5 Të pandehur për vepra penale

Veprat penale	2015	2016	2017	2018	2019
Vrasje me dashje	166	192	98	111	132
Vrasje të mbetura në tentativë	27	51	33	38	32
Krime me dashje kundër shëndetit	828	705	698	622	542
Krime seksuale	94	90	79	66	111
Vjedhje (neni 134)	1.937	1.690	1.376	1.299	1.078
Vjedhja me dhunë	144	94	87	73	70
Vjedhja me armë	41	27	17	13	18
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	114	88	78	68	86
Mashtrime	581	696	827	446	384
Falsifikim monedhash	38	53	41	45	38
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.222	1.281	1.194	1.198	1.038
Krime në fushën e drogës	1.199	1.693	1.819	1.183	921
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	3.405	3.186	3.034	3.596	3.152
Tjetër	9.925	7.600	6.975	7.491	7.119
Gjithsej	19.721	17.446	16.356	16.249	14.721

Në vitin 2019, meshkuj përbëjnë 94,2 % në totalin e personave të pandehur.

Fig. 6 Persona të pandehur sipas gjnisë



Të burgosur


Në 2019, numri i të burgosurve është 5.045, 5,1 % më pak, krahasuar me vitin 2018. Në raport me popullsinë, në 2019 janë 21 të burgosur për 10 mijë banorë, nga 22 të burgosur që ishin një vit më parë. Meshkujt përbëjnë 98,3 % të totalit të të burgosurve.

Tab. 7 Të burgosur sipas veprave penale

Vepra penale	2015	2016	2017	2018	2019
Vjedhje	1.212	956	1.049	859	811
Vrasje	1.470	961	994	1.053	1.006
Plagosje	218	100	103	94	74
Marrëdhënie seksuale me dhunë	134	83	90	108	38
Krime në fushën e drogës	1.329	1.530	1.598	1.706	1.580
Organizata kriminale	28	22	26	52	78
Mashtrim	68	53	99	112	129
Shfrytëzim prostitucioni	79	58	90	78	67
Të tjera	1.395	2.183	1.369	1.254	1.262
Gjithsej	5.933	5.946	5.418	5.316	5.045

Grupmosha 21-29 vjeç ka normën më të lartë të të burgosurve, në raport me popullsinë. Personat mbi 60 vjeç dhe nën 20 vjeç kanë normën më të ulët të të burgosurve.

Fig. 7 Të burgosur për 10 mijë banorë sipas grupmoshës



Metodologjia

1. Veprat penale

Statistikat mbi veprat penale të evidentuara japin një pamje gjithëpërfshirëse të të gjithë rasteve të raportuara në polici. Ato tregojnë numrin e veprave penale që janë raportuar dhe evidentuar si vepra penale nga policia.

2. Autorë

Të dhënat mbi autorët bazohen në persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale. Totali i autorëve paraqet numrin e autorëve për vepër penale. Një autorë mund të jetë i pranishëm në më shumë se një vepër penale.

3. Persona të dëmtuar

Të dëmtuarit/viktimat e veprave penale i referohen personave të dëmtuar nga kryerja e një vepre penale gjatë një viti.

4. Procedime penale

Statistikat mbi procedimet penale paraqesin të dhëna për procedimet penale të regjistruara, pushuara, pezulluara dhe procedimet penale të dërguara për gjykim.

Procedime të regjistruara janë procedimet që kanë filluar të hetohen në vitin korrent. Procedime të pushuara janë procedimet për të cilat prokurori në përfundim të hetimeve paraprake vendos vetë ose i kërkon gjykatës pushimin e çështjes ose akuzës, kur janë rastet e parashikuara nga neni 328 i Kodit të Procedurës Penale. Procedime të pezulluara është vendimarrja e prokurorit në rastet kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm. Statistikat mbi procedimet penale për gjykim paraqesin numrin e çështjeve të dërguara në gjykatë për gjykim të një personi të akuzuar ose që do të akuzohet për kryerjen e një vepre penale.

5. Të pandehur

Statistikat për të pandehurit paraqesin të dhëna për numrin e të pandehurve të rinj që u nënshtrohen procedimeve penale për gjykim gjatë vitit referues. Në sistemin e drejtësisë, në këtë fazë ata nuk janë më persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale, siç ishin në polici por janë persona të akuzuar. Për qëllime statistikore, në totalin e të pandehurve janë shtuar të dhëna edhe për personat nën hetim.

6. Të burgosur

Të dhënat për personat në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale i referohen numrit gjithsej të personave të dënuar me burg dhe të paraburgosur, në burgje, qendrat e paraburgimit, institucionet e burgosjes së të miturve si edhe spitale të burgut, deri në dhjetor të çdo viti. Të dënuar me burg i referohet personave të cilët ndodhen në burgje, të cilët kanë dënimin përfundimtar me burgim. Të paraburgosur i referohet personave që janë në qendrat e paraburgimit dhe në burgje, ndaj ndaj të cilëve është marrë masë sigurimi “arrest në burg”.

Përkufizime

Vrasje me dashje: Vepër i kundraligjshëm, me anë të së cilës i hiqet jeta një personi tjetër me dashje. Përshihen veprat penale si: Neni 76 Vrasje me dashje, Neni 77 Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër, Neni 78 Vrasje me paramendim, Neni 78/a Vrasje për gjakmarrje, Neni 79 Vrasje në rrethana cilësuese, Neni 79/a Vrasje e funksionarëve publik, Neni 79/b Vrasja e punonjësve të policisë së shtetit, Neni 79/c Vrasje për shkak të mardhënieve familjare, Neni 81 Vrasje e foshnjës.

Krime seksuale: Përfshihen nenet 100-108/a të Kodit Penal.

Krime me dashje kundër shëndetit: Përfshihen nenet 86-90 të Kodit Penal.

Mashtrim: Përfshihen nenet 143-149/b të Kodit Penal.

Fallsifikim monedhash: Përfshihet neni 183 i Kodit Penal.

Krime në fushën e drogës: Përfshihen veprat penale si: Neni 283 Prodhimi dhe shitja e narkotikëve, Neni 283/a Trafikimi i narkotikëve, Neni 284 Kultivimi i bimëve narkotike, Neni 284/c Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope.

Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor: Përfshihet veprat penale si: Neni 290 Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, Neni 291 Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor në gjendje të dehur, pa dëshmi, Neni 273 Largim nga vendi i aksidentit.

Burimi i të dhënave:

Të dhënat janë siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Të dhënat mbi statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx>/Politika e revizionimit statistikor.